



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 13.7, 14.7 dhe 19.2 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14 të datës 03.07.2003, të shpallur sipas Rregullores nr. 2003/30 dt. 10. 09.2003, të nenit 3 al. 1 pika b, të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45 të dt. 11. gusht 2000, të nenit 19 al.1. pika b. dhe nenit 40 al. 3 pika II. të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 22.04.2004, merr

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PROJEKTPLANIT STRATEGJIK-ZHVILLIMI URBAN I PRISHTINËS

Neni 1

Miratohet Projektplani strategjik-Zhvillimi urban i Prishtinës.
Projektplani nga al. 1 e këtij neni përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

Neni 2

Projektplani nga neni 1 i këtij Vendimi, duhet t'i nënshtrohet shqyrtimit publik.
Shqyrtimi publik zgjat 30 ditë, gjegjesisht prej 26 prill deri më 26 maj 2004.
Organizimin e shqyrtimit publik të Projektplanit, sipas këtij Vendimi, duhet ta bëjë Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë i Komunës së Prishtinës.

Neni 3

Pas përfundimit të shqyrtimit publik të Projektplanit nga neni 1 i këtij Vendimi, Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, do të kryejë veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij Plani, në mënyrë që i njëjti t'i prezantohet Kuvendit Komunal për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi dhe aplikohet ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 031-1231 DT.27.05.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri